



BANKA KOMBETARE TREGTARE

KREDI PËR MAKINË TË PËRDORUR ME PENG FLETË E STANDARTIZUAR E INFORMACIONIT PARAKONTRAKTOR

Zërat	Përshkrimi
Teksti prezantues	Ky dokument nuk përbën një ofertë ligjore detyruese. Shifrat janë dhënë në mirëbesim dhe janë një prezantim i saktë i ofertës që banka do të bëjë sipas kushteve aktuale të tregut, bazuar në informacionin e dhënë. Megjithëkëtë, këto shifra mund të luhaten sipas kushteve të tregut. Dhënia e këtij informacioni nuk përbën detyrimin e kësaj të fundit për të akorduar kredi.
1. Banka	BANKA KOMBETARE TREGTARE (BKT) SH.A Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Tiranë Adresa e web-it: www.bkt.com.al Email: info@bkt.com.al Numri i telefonit: 042 266 288
2. Emri i Produktit	Kredi për Blerje Makine të Përdorur
3. Lloji i Kredisë	Kredi e siguar me pengun e makinës që po blihet
4. Qëllimi i produktit	Nëpërmjet kredisë për makinë synohet të përmbushen kërkesat e klientëve, për Blerje makine të përdorur të prodhuar deri në 5 vjet përpara nga data e aplikimit. Kjo lloj kredie mund të përfitohet vetëm nga individët. Të drejtën e aplikimit e kanë vetëm individët që do të përdorin këtë makinë për përdorim personal. Makineritë e përdorura për aktivitet nuk janë subjekt i këtij produkti.
5. Përshkrimi i produktit	Ky produkt përdoret për qëllimin e parashikur në pikën 4 ku si garanci banka do të kërkojë barrësim të makinës që do të blihet si dhe sigurimin kasko të makinës në favor të saj dhe dorëzaninë e dy personave. Shlyerja e kredisë do të kryhet me këste të barabarta mujore (kryegjë + interes) sipas aneksit të shlyerjes dhe jo si shlyrje e njëherëshme në fund të afatit të maturimit. Banka financon deri në 60% të çmimit (bazuar tek kontrata e shitjes), por jo më shumë se 80% të vlerës së siguar e mjetit, të siguar nga një kompani sigurimi.
6. Norma e interesit (tregon llojin e interesit dhe kohëzgjatjen e periudhës së përcaktuar)	Monedha : LEK LEK - Bono Thesari 1-vj+ 8% Norma e ofruar e interesit është e ndryshueshme sipas luhatjeve të Bonove të Thesarit, me afat 1-vjeçar, çdo 12 muaj të kredisë . Aplikanti do të informohet nëpërmjet telefonit, postës elektronike ose me postë për çdo ndryshim në kushtet dhe termat e kontratës së kredisë.
7. Norma efektive e interesit	Norma efektive e interesit (NEI) shpreh totalin e kostos së kredisë duke përfshirë dhe interesat, komisionet dhe çdo lloj tjetër shpenzimi që kredimarrësi paguan në lidhje me kontratën e kredisë. Për qëllime të llogaritjes së NEI totali i kostos së kredisë nuk përfshin shpenzime që nuk njihen në datën e llogaritjes së NEI, shpenzime të pagueshme nga kredimarrësi të detyrimeve për moszbatimin e kushteve të parashikuara në kontratë, kostot e pagueshme nga kredimarrësi lidhur me marrëveshjen e kredisë për persona të tjerë (për shembull, tarifat noteriale, tarifat e Zyrove Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, tarifat e Regjistrimit të Barrëve Siguruese, të përcaktuara sipas akteve përkatëse) dhe çdo shpenzim në përgjithësi të detyruar për regjistrimin dhe garancitë; shpenzimet për siguracionin dhe/ose garancitë që nuk janë të detyrueshme, shpenzime për komisione të aplikuara për fondet e papërdorura dhe shpenzime komisionesh për ndryshim të kushteve kontraktore. NEI do të llogaritet me supozimin që :

	<ul style="list-style-type: none"> - kontrata kredisë është e vlefshme për periudhën e rënë dakord, dhe - palët plotësojnë detyrimet e tyre, sipas kushteve dhe datës së rënë dakord në kontratën e kredisë, dhe - përqindjet e interesit dhe shpenzimet e tjera që përfshihen në llogaritjen e NEI mbeten të pandryshuara deri në fund të kontratës së kredisë. <p>Klienti do të informohet për vlerën e përafërt të NEI në momentin e aplikimit dhe gjithashtu për vlerën e saktë në disbursimin e fondeve (me Aneksin e Planit të Pagesës).</p> <p>Pas disbursimit të kredisë aplikanti do të pajiset me Aneksin e Planit të Pagesës në të cilën është shprehur në % Norma Efektive e Interesit (NEI) e cila i referohet vlerës së normës bazë (Bono Thesari 1-vjeçare) sipas kushteve të tregut në momentin në të cilin realizohet disbursimi i kredisë.</p>
8. Vlera e kredisë dhe monedha e ofruar	Shuma maksimale e kredisë – LEK – 1,000,000 Lek
9. Kohëzgjatja e kontratës së kredisë për makine të përdorur	Afati maksimal – deri në 4 vjet (ose 48 muaj)
10. Çelja dhe Lëvrimi i Kredisë	<ul style="list-style-type: none"> - Si kusht për lëvrimin e kredisë, Kredimarrësi do të hapë një ose më shumë llogari rrjedhëse pranë Bankës Kombëtare Tregtare, e quajtur “llogaria e kredisë”, në të cilën Banka do të bëjë disbursimin e fondeve dhe nëpërmjet së cilës do të bëhet ripagimi kredisë. - Tërheqja e kredisë do të bëhet në një nga mënyrat: me anë të tërheqjes në të holla, me anë të tërheqjes me mjete elektronike, me anë të një çeku të lëshuar nga vetë klienti mbi bankën, me anë të urdhër-pagesës së dhënë me shkrim në favor të të tretëve. - Kur gjatë disbursimit Banka konstaton se Kredimarrësi ka dalë jashtë kushteve të parashikuara në Kontratën e Kredisë nënshkruar nga palët, Banka ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kësaj kontrate që do të shoqërohet me kthimin e shumave të përdorura deri në atë moment dhe interesin përkatës.
11. Numri dhe frekuenca e pagesave	Shlyerja e kredisë do të kryhet me këste mujore të barabarta. Numri total i kësteve varet nga afati i maturimit.
12. Vlera e çdo kësti për shlyerjen e kredisë për makine të përdorur	Kësti = Shuma e kryegjësë + shumën e interesit

**13. Tabela
illustruese e
amortizimit të
kredisë (plani i
shlyerjeve)**

Termat e kredisë dhe tabela për llogaritjen e NEI

Shuma e kredisë	500,000	Lek
Afati i kredisë	13	Muaj
Komisioni i Disbursimit	3.22	%
Prim për Sigurim makine	1000	Lek
Norma Bazë (Bono thesari 1 vjecare)	3.22	%
Marzhi	8.00	%
Norma e Interesit për kredinë	11.22	%
Kësti	41,025.69	Lek
Vlera Totale për të paguar në fund të periudhës (Kryegjë+Interes)	533,333.96	Lek
Norma Efektive e Interesit (NEI)	17.40	%

* Përlllogaritja e normës së interesit pas këstit të 12-të i referohet normës bazë që është në fuqi në muajin aktual

Tabela e amortizimit të kredisë (plani i shlyerjeve)

Muaji	Balanca Fillestare	Shuma e interesit	Ripagimi i kryegjësë	Kësti Mujor i Kredisë	Balanca Përfundimtare
1	500,000.00	4,675.00	36,350.69	41,025.69	463,649.31
2	463,649.31	4,335.12	36,690.57	41,025.69	426,958.74
3	426,958.74	3,992.06	37,033.63	41,025.69	389,925.12
4	389,925.12	3,645.80	37,379.89	41,025.69	352,545.23
5	352,545.23	3,296.30	37,729.39	41,025.69	314,815.83
6	314,815.83	2,943.53	38,082.16	41,025.69	276,733.67
7	276,733.67	2,587.46	38,438.23	41,025.69	238,295.44
8	238,295.44	2,228.06	38,797.63	41,025.69	199,497.82
9	199,497.82	1,865.30	39,160.39	41,025.69	160,337.43
10	160,337.43	1,499.15	39,526.53	41,025.69	120,810.90
11	120,810.90	1,129.58	39,896.11	41,025.69	80,914.79
12	80,914.79	756.55	40,269.14	41,025.69	40,645.65

Frekuenca e rishikimit të normës bazë të interesit në këtë rast Bono Thesari bëhet çdo 12 muaj të kredisë, pra në çdo rast rishikimi i normës së interesit do të bëhet në datën e kesteve që janë shumëfisha të 12-ës deri në maturimin e kredisë. Kjo është një tabelë ilustruese dhe përlllogaritja e kesteve pas këstit të 12-të i referohet normës bazë të interesit që është në fuqi në muajin aktual.

14. Kosto shtesë të pakthyeshme në rastin kur aplikohen të tilla

Nuk ka.

15. Kosto shtesë të tjera

Lloji i shpenzimit	Vlera
Shpenzime noteriale	~ 3,800 Lek/ për kontratë
Shpenzimet e barrësimit	~ 1,400 Lek
Primi i policës së sigurimit kasko të makinës	Varet nga vlera e makinës
Komision disbursimi	1.5 % e shumës së kredisë

Kostot e mësipërme klasifikohen si kosto pas miratimit të kredisë. Këto shpenzime janë të pashmangëshme dhe të detyrueshme para disbursimit të kredisë. Shpenzimet e noterizimit të kontratave të kredisë, barrësimit të pengut dhe komisioni i angazhimit ekzekutohen vetëm një herë, ndërsa primet e policave të sigurimit të makinës përsëriten çdo vit. □

16. Shlyerja para afatit të maturimit (kur është e aplikueshme)

Banka pranon shlyerje të parakohshme të kredisë pa kosto shtesë për klientin, të barabartë me 0% të shumës së papaguar.

17. Njoftimi zyrtar midis palëve

Të gjithë njoftimet, komunikimet midis palëve do të bëhen me shkrim të dorëzuara personalisht ose me postë të regjistruar (rekomande) në adresën e

	<p>përcaktuar në Kontratën e Kredisë, ose kur është e mundshme me një mjet të qëndrueshëm komunikimi (e-mail të përcaktuar në Kontratën e Kredisë, disketë, CD-ROM, DVD, Kutit Postare).</p> <p>Kredimarrësi deklaron dhe pranon që të gjithë llojet e njoftimeve të bëra në adresat e deklaruara do të konsiderohen si të marra nga ai. Kredimarrësi mund t'i paraqesë Bankës reklamimet e tij, për sa njoftohet, brenda një afati prej 15 ditësh kalendarike.</p> <p>Kredimarrësi është i detyruar që për çdo ndryshim në adresat e tij të njoftojë Bankën brenda 15 diteve kalendarike për këtë ndryshim. Për sa kohë që ai nuk ka njoftuar adresën e re, Kredimarrësi nuk ka të drejtë të kundërshtojë njoftimet e bëra në adresën e mëparshme.</p>
18. E drejta e tërheqjes nga kontrata e kredisë	<p>Klienti ka të drejtë të tërhiqet nga kontrata e Kredisë brenda një periudhe kalendarike 14 ditore. Ky afat fillon nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate. Në rastet kur shuma e kredisë është disbursuar në llogarinë e klientit dhe ky i fundit ushtron të drejtën për t'u tërhequr nga Kontrata e Kredisë, atëherë klienti pranon dhe merr përsipër të shlyejë kryegjënë dhe gjithë detyrimet për interesa dhe /ose penalitete, si dhe shpenzime të tjera të mundshme të bankës të krijuara me palë të treta për efekt të disbursimit të kësaj shume. Nëse kredimarrësi tërhiqet nga kontrata e kredisë, edhe bashkëkredimarrësi ose dorëzanësi gjithashtu, tërhiqet nga kontrata e kredisë ose tërheq garancinë/të e vendosura prej tij për ekzekutimin e kontratës.</p>
19. Skemat e brendshme të ankimit	<ul style="list-style-type: none"> - Ankesë me shkrim pranë çdo dege - Vizitë pranë çdo dege - Nëpërmjet telefonit (+355 42 266 288) call center - Nëpërmjet adresës elektronike info@bkt.com.al
20. Penalitete të tjera	<ul style="list-style-type: none"> - Në rast se Banka zbulon që kredia nuk është përdorur për qëllimin e akorduar, atëherë ajo ka të drejtë që të kërkojë menjëherë rikthimin e kredisë dhe interesave të akumuluar, ose në rast se e gjykon të arsyeshme në vend të aplikimit të veprimit të sipërpërmendur, mund të aplikojë 1% penalitet mbi shumën fillestare të kredisë. - Në rast të mospagimit të komisioneve dhe interesit, Banka ka të drejtë të aplikojë një penalitet prej 4(katër)% në Lek, në muaj mbi shumën e papaguar të komisionit dhe interesit. - Në rast se Kredimarrësi është në pamundësi për të ripaguar në kohë këstin e maturuar (interesin ose kryegjën), Banka përveç normës së interesit normal, ka të drejtë të aplikojë penalitet në masën 4(katër)% në Lek në muaj, i llogaritur mbi detyrimin e këstit të rradhës së pa paguar (kryegjë + interes) për periudhën në të cilën ai është më vonësë në bazë të kushteve të kësaj kontrate. <p>Për llogaritja e penalitetit: Shuma në vonësë x normën e penalitet% x 12 muaj / 360 ditë x ditët në vonësë.</p>
21. Periudha kohore e vlefshmërisë së informacionit parakontraktor	<p>Periudha kohore e vlefshmërisë së informacionit parakontraktor është 7(shtatë) ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të këtij informacioni nga klienti</p>

_____/_____/_____/_____
(Qyteti, dd,mm,vvvv)

Klienti: Emër Mbiemër
(Firma)